



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 22 prill 2026

Kodi i ZRRE-së: V\_3208\_2026

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 16, paragrafi 1.12 dhe paragrafi 1.13 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Nenit 12 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe Kërkesën e KOSTT SH.A, me nr. prot. 3333 të datës 12.12.2025 për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2030,

në seancën e mbajtur me datë 22 prill 2026 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** - Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2030 për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A.
- II. **OBLIGOHET** – KOSTT SH.A, që të zbatoj projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Transmetimit.

## A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 12.12.2025 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A. për shqyrtim dhe aprovim të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2030.
- o ZRRE ka analizuar dokumentin, dhe ka konstatuar se i njëjti është harmonizuar me Planin Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit, dokumentacionin e planifikimit hapësinor, Planin Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes, dhe ka konstatuar se janë në pajtim me kërkesat ligjore.
- o ZRRE pas vlerësimit të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2030, të njëjtin e ka hapur për diskutim publik për të pranuar komete, sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarat po ashtu edhe nga palët e interesit.
- o Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta mes ZRRE, KOSTT dhe KEDS rreth harmonizimit të planeve, ZRRE ka vlerësuar se janë përfshirë të gjitha komentet dhe arsyetimet e nevojshme për shqyrtim dhe aprovim.



- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2030 ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: **Plani Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026 – 2030.**

**Bordi i ZRRE-së:**

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtar

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të ZRRE-së.